



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQARËVE

**Raport vjetor i punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve për vitin
2023**

Sipas Rregullores 01/2021 Komisioni për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve përbëhet prej 13 (trembëdhjetë) anëtarëve/gjyqtarë, duke përfshirë këtu edhe Kryetarin e Komisionit. Komisioni përbëhet edhe prej 3 (tre) anëtarëve rezervë. Komisioni përbëhet nga gjyqtarë të të gjitha gjykatave, duke përfshirë 5 (pesë) gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 5 (pesë) gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe 3 (tre) gjyqtarë nga Gjykatat Themelore. Anëtarët rezervë zgjedhën nga 1 (një) gjyqtar nga secila instancë gjyqësore.

Në bazë të vendimit të KGJK-së nr.117/2021, të datës 30 prill 2021, është bërë zgjedhja e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës, në përbërje prej 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarëve, nga të cilët 11 (njëmbëdhjetë) me mandat prej 3 (tri) vitesh, ndërsa 4 (katër) me mandat prej 2 (dy) vitesh.

Komisioni nga data 30.04.2023 ka funksionuar me 10 (dhjetë) anëtarë, pasi që 1 (një) anëtar është avancuar në detyrë në Gjykatën Supreme, 4 (katër) anëtarëve iu ka përfunduar mandati dy vjeçar, dhe 1 (një) anëtar ka arritur kohën e pensionimit, ndërsa nga data 31.10.2023 Komisionit për Vlerësimin e Performancës iu është bashkangjitur edhe një anëtar/gjyqtar nga Gjykata Supreme.

Në përputhje me Ligjin për KGJK-në dhe Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve, Komisioni gjatë këtij viti ka mbajtur 8 (tetë) seanca plenare në të cilat janë aprovuar gjithsej 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) raporte të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve.

Komisioni gjatë kësaj periudhe ka pranuar 25 (njëzet e pesë) kundërshtime ndaj raporteve të vlerësimit. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha kundërshtimet dhe ka nxjerrë 25 (njëzet e pesë) vendime. Prej tyre 3 (tre) kundërshtime janë aprovuar në tërësi, 6 (gjashtë) kundërshtime janë aprovuar pjesërisht, ndërsa 15 (pesëmbëdhjetë) janë refuzuar si të pa bazuara dhe 1 (një) kundërshtim është propozuar të paraqitet në Këshill.

Pas vendimit të Komisionit për Vlerësimin e Performancës, 3 (tre) nga gjyqtarët kanë paraqitur ankesë drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë rast Këshilli ka vendosur për hedhjen poshtë të të 3 (tri) ankesave.

Bazuar në Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, Komisioni ka përfunduar vlerësimin për këto kategori të gjyqtarëve:

- 2 (dy) gjyqtarë për ngritje në detyrë për pozitën e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- 1 (një) gjyqtar me mandat të përhershëm në Gjykatën Themelore, për ngritje në detyrë për pozitën e gjyqtarit në Departamentin Special - Gjykata Themelore Prishtinë;
- 2 (dy) gjyqtarë pas përfundimit të mandatit si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Performancës së Gjyqtarëve;
- 89 (tetëdhjetë e nëntë) gjyqtarë me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas metodës Random për vitin 2023, periudha e vlerësimit 2020 - 2022;
- 22 (njëzet e dy) gjyqtarë para përfundimit të mandatit fillestar me qëllim të Ri-emërimit me mandat të përhershëm për periudhën e vlerësimit 2021 - 2023;
- 45 (katër dhjetë e pesë) gjyqtarë pas përfundimit të trajnimit fillestar 12 mujor në Akademinë e Drejtësisë;

Në vijim tabela me të dhënat përkatëse me kategorinë e gjyqtarëve të vlerësuar dhe me shkallët e arritura të vlerësimit:

Proceset	Nr. Gjyqtarëve të vlerësuar	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Ngritje në detyrë	3					3
Pas përfundimit të mandatit si anëtarë të KVPJGJ	2					2
Random 2020-2022	89			1	48	40
Ri-emërim	22				14	8
Trajnimi fillestar ¹	45			18	27	
Gjithsej	161			19	89	53

Aktivitetet tjera të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

-
- ¹Bazuar në Rregulloren 03/2017 për Programin e Trajnimit Fillestar / Akademia e Drejtësisë dhe nenit 16 të Rregullores 01/2021 për vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve:

Me datë 17, 18 dhe 19 dhjetor 2023, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen e projektit Chemonics ka mbajtur në Podgoricë trajnimin me objektivat:

1. Të kuptoj efikasitetin dhe dobitë e sistemeve të vlerësimit;
2. Të kuptojë dhe të jetë në gjendje të shpjegojë në detaje procesin e vlerësimit të KGJK-së;
3. Detyrat e anëtarit të komisionit vlerësues;
4. Zbatimi dhe kuptimi i statistikave cilësore dhe sasiore.

Si dhe Komisioni KVPGJ nga kjo punëtori ka dal me propozim dhe rekomandim për ndryshim e Rregullores dhe Udhëzuesit për Vlerësim te Performancës së Gjyqtarëve si dhe nevojën për Trajnimin e anëtarëve të ri të KVGJP-së.

Prishtinë,
Dhjetor 2023A